



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

**MBI PROGRAMIN E BURSIVE TË SHTETIT TË KATARIT,**

**VITI AKADEMIK 2020-2021**

Në kuadër të "Programit të Bursave të Shtetit të Katarit", Fondi i Katarit për Zhvillimin dhe Instituti "Doha" për Studime për të Diplomuarit, bazuar në një marrëveshje partneriteti, ofrojnë bursa studimi për shtetasit ndërkombëtarë që dëshirojnë të studiojnë në shtetin e Katarit për vitin akademik 2020-2021. Gjithashtu, Fondi i Katarit për zhvillimin ka nënshkruar një marrëveshje partneriteti me Qendrën e Gjuhës Arabe dhe në Universitetin e Katarit për bursa studimi për shtetasit ndërkombëtarë.

Shteti i Katarit mbështet përpjekjet si një kontribuues efektiv të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm për arsim cilësor.

Procesi i aplikimit kalon në dy faza si në vijim:

**Në fazën e parë**, kandidatët e huaj fillimisht duhet të aplikojë për praninë në faqen zyrtare të internetit të Institutit Doha për Studime Pasuniversitare dhe me Qendrën e Gjuhës Arabe në Universitetin e Katarit.

**Në fazën e dytë**, kandidatët e huaj, pasi të pranohen dhe regjistrohen, duhet të kontaktojnë Departamentin e Pranimi për të shprehur dëshirën e tyre për të aplikuar në kuadër të "Programit të Bursave të Shtetit të Katarit".

Për një koordinim me organizatorët e programit të bursave dhe për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit për bursat e ofruara nga qeveria e Katarit, referojuni adresave elektronike si më poshtë:

Univerity of Qatar: [internationalstudent@qu.edu.qa](mailto:internationalstudent@qu.edu.qa);

Doha institute for graduate studies: [deanstudentsaffairs@dohainstitute.edu.qa](mailto:deanstudentsaffairs@dohainstitute.edu.qa);

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS**